



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Aplikimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës

Trajnuesi
Ramush Bardiqi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Prishtinë 28.06.2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	
Objektivat mësimore.....	
Metodat e të mësuarit	
Pritjet nga pjesëmarrësit	
Burimet dhe literatura.....	

PËRMBLEDHJE

I. VLERA DOGANORE E MALLRAVE

1.1 Metodat e vlerësimit të mallit

1.2 shpenzimet e transportit

II KLASIFIKIMI I MALLRAVE SIPAS TARIK-UT DHE KDA-SË

2.1 Dokumentacioni i nevojshëm për Origjinën e mallit

2.2 Lirimi nga taksat të Mallrave sipas tarifës dhe KDA-se

III KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DOGANORE

III. 1 Procedura kundërvajtëse sipas KDA-se

3.2 Procedura Mandatore

3.3 Procedura e Rregullt.

VI. TAKSA E PRODUKTEVE TË AKCIZES

V. IMPORTI I PERKOHSHEM

VI. Ankesat/Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit

Hyrje

Çështjet Doganore janë një fushë shumë e gjerë mirëpo jo shumë e trajtuar deri me tani dhe kjo fushe përfshinë trajtimin e shume lendeve, dhe zhvillimin e procedurat e ankesave nga subjektet ne procedure dhe procedua gjyqësore ne Gjykate. Republika e Kosovës shumicën e mallrave i importon nga jashtë kjo bënë që të ketë aktivitete të shumta doganore për shkake te impaktit në taksa doganore dhe përpjekjet e palëve për shmangien e këtyre taksave, andaj si rezultat e këtyre aktiviteteve në shumë lënde në gjykatat e Kosovës kemi si pale Doganën, te cilat kane kompetence për mbledhjen e taksave doganore ne Republikën e Kosovës.

Ky trajnim do të mundësoj pjesëmarrësve të njoftohen për së afërmi me praktiken dhe qëndrimet e gjykatës në lidhje me rastet të cilat i trajton dhe i vendos gjykata, përfshirë vendosjes se vlerësimit te dhe kodifikimit te mallit si dhe përcaktimin e tatimit ne prone. Institucionet e zbatimit te legjislacionit ne fushën doganore dhe tatimore ne Kosove, si dhe instrumentet dhe mekanizmat e inkasimit te hyrave për Buxhetin e Kosovës, ndëshkimet ne rast te veprimeve te kundërligjshme (Evazionit Fiskal) nga subjekteve ekonomike dhe personave fizik gjate procedurës se mbledhjes se detyrueshme te taksave dhe tatimit. Në trajtimin e kësaj teme si qëllim kryesor do te jete interpretimi i legjislacionit në gjykimin e çështjeve Doganore dhe Tatimore, që mund të prekin të drejtat e personave fizikë e juridikë.

Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojne njohuritë lidhur me sistemin Doganor e ne veçanti te këtë njohuri dhe te dalloj metodat e vlerësimit te mallit gjate procedurës se zhdoganimit, si dhe aplikimin e dispozitave ligjore ne përputhje me Metodatat e vlerësimit.
- Pjesëmarrësit te munden te identifikoj dhe klasifikoj Kodet Tarifor te mallrave dhe aplikimin e marrëveshjeve kontraktuese te Kosovës me shtetet tjera (CEFTA,MSA, etj, si marrëveshje mbizotëruese ne raport me TARIK-UN dhe KDA-ne.
- Kualifikoj drejt veprimet ndëshkuese- kundërvajtëse sipas Kodit Doganor dhe Akcizave te Kosovës, dhe përgjegjësit e subjekteve ne procedure.
- Të përcaktoj qarte, se cilat produkte i nenshtrohen taksës se Akcizes, dhe kuptoj drejte procedurat me ndikim ekonomik Importet e Perkoshme kushtet dhe kriteret per lejmin e ketij importi.
- Te Kuptoj drejte proceduren e ankeses per rishqyrimin e vendimeve te dogana e Kosoves

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të kenë një pasqyre me te qarte lidhur me këto çështje juridike, si dhe do te kenë njohuri me shume rreth Çështjeve Doganore, dhe juridiksionin e këtyre çështje.

Metodat e të mësuarit

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjate trajnimit do te adresohen përmes metodave të kombinuara trajnuese shpjegime teorike, diskutimet interaktive, prezantime në PowerPoint, studimi i rasteve praktike nga praktika Gjyqësore, punë në grupe, etj. 50% te kohës do të jetë për pjesëmarrësit dhe 50% e kohës tjetër do të jetë për të trajnuarit.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Në këtë pjesë duhet të paraqitet se çfarë duhet pritur nga pjesëmarrësit si dhe cilat do të ishin pritjet që kanë pjesëmarrësit nga ky trajnim.

Nga pjesëmarrësit pritet që te përgatiten për njohurit bazike dhe shkathtësitë për ligjin e procedurës administrative ne përgjithësi si dhe legjislacioni doganore dhe tatimore ne veçanti, si dhe qasje me aktive gjate trajnimit, bashkëbisedimit dhe punës praktike dhe individuale dhe grupe ne mënyre që pjesëmarrësit te përfitojnë dije dhe shkathtësi ne pajtim me qëllimet dhe objektivat e këtij trajnimi.

Trajtimin e këtyre çështjeve do te mundësoj pjesëmarrësve që te kenë një pasqyre me te qarte lidhur me këto çështje juridike-administrative, dhe pas këtij trajnimi pjesëmarrësit do te kenë njohuri me shume ne Çështjeve Doganore dhe tatimore, dhe juridiksionin gjyqësor te këtyre çështje. Pjesëmarrësit priten te jene aktive gjate çdo shqyrtime duke dhënë kontributin e tyre ne pyetje, përgjigje, diskutime dhe angazhim ne pune praktike gjate trajnimit.

BURIMET DHE LITERATURA

- Kodi Doganor dhe i Akcizave Nr. 03/L-109 (Nëntor 2008).
- Ligji Nr. 04/L-099 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë. (Qershor 2012).
- Udhëzim Administrativ (Qrk) Nr. 04/2014 Për Përcaktimin E Kostos Së Shpenzimeve Të Transportit të Mallrave të Importuara.
- Udhëzimi Administrativ nr. 11 /2009, për Implementimin e Kodit te Doganave dhe Akcizës.

-Raste studimore nga praktika gjyqësore.

1. VLERA DOGANORE E MALLRAVE

Vlera doganore i referohet vlerës së mallrave të importuara që përdoret për të llogaritur detyrimetdoganore të importit dhe tatimet. Shumica e importeve vlerësohen në bazë të "vlerës së transaksionit (çmimi i kontratës), dmth, çmimi i paguar ose që duhet paguar për mallrat në vendin e tyre të eksportimit kur shiten në Kosovë, me disa përshtatje të caktuara. Megjithatë, në qoftë se nuk është e mundur për të përdorur vlerën e transaksionit, 5 metodat e tjera të vlerësimit mund të përdoren sipas radhës. Kodi Doganor i Kosovës siguron autoritetin për gjashtë metodat që duhet të zbatohen sipas radhës në përcaktimin e vlerës doganore të mallrave të importuara (shih nenet 31-40 të Kodit). Këto dispozita në Kod bazohen në Marrëveshjen për Vlerësimin Doganor (MVD) të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT-së) për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave të importuara ("MVD-OBT" ose "MVD"). Të njëjtat parime dhe praktika zbatohen edhe për vlerësimin e importeve në Bashkimin Evropian dhe për këtë çështje të gjitha 157-të ekonomitë që janë anëtarë të OBT-së dhe shumë vende të tjera po ashtu.

Neni 34 i KDA-së parasheh se kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë: a) Vlera e transaksionit të mallrave identike të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë, ose përafërsisht, në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar; Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë ose përafërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar; c) Vlera e bazuar në çmimin për njësi, në të cilin mallrat e importuara që korrespondojnë me mallrat identike ose të ngjashme të importuara dhe të shitura brenda Kosovës, në sasi të përgjithshme më të madhe, personave që nuk janë në lidhje me shitësin; d) Vlera e llogaritur përbëhet nga shuma e Kostos apo vlerës së materialeve dhe fabrikimit apo përpunimit tjetër për prodhimin e mallrave të importuara, - Shumës së fitimit dhe të shpenzimeve të përgjithshme, që ka bërë prodhuesi në vendin e eksportit për t'i eksportuar në drejtim të Kosovës, të barabarta me shumën që zakonisht reflektohen në shitjen e mallrave të së njëjtës kategori apo të e njëjtit lloj me mallrat të cilat po vlerësohen, - Kostos ose vlerës së elementeve të përmendur në nenin 36 (1) (e).

Nenet 60-82 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 "që vendosin dispozitat për zbatimin e Kodit Doganor", sigurojnë informacion më të detajuar mbi vlerën doganore dhe se si të përcaktohet vlera e mallrave të importuara. Aneksi 12 i këtij Udhëzimi Administrativ ofron Shënimet Shpjeguese mbi Vlerën Doganore. Nenet 31-40 të Kodit Doganor të Kosovës elaborojnë rregullat për përcaktimin e vlerës së mallrave të importuara, në mënyrë që të sigurohet uniformitet më i madh dhe siguri në mënyrën se si mund të përcaktohen vlerat ligjrisht. Parashikimi për tregtarët është një objektiv kryesor i këtyre dispozitave të Kodit lidhur me vlerën doganore, pasi këto dispozita të vlerësimit në Kodin Doganor të Kosovës me besnikëri ndjekin të njëjtat parime të MVD - në mënyrë që të sigurojnë parashikueshmëri për importuesit e Kosovës.

Vlera e Mallrave për qëllime Doganore (Kapitulli 3 i Nenit 32 i KDA-së-Dispozitat e këtij kapitulli do

të caktojnë vlerën doganore me qëllim të aplikimit të Tarifës Doganore të Kosovës, si dhe masat jo tarifore të parapara me dispozita tjera të Kosovës, që rregullojnë fushat e veçanta që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave. Qëllimi Fiskal: Përcaktimi i vlerës së mallrave të importuara është i nevojshëm dhe thelbësor për përlogaritjen e detyrime doganore "ad valorem".

Sistemi për përcaktimin e vlerave të importit në Kosovë e njih nevojën për një sistem të drejtë, uniform dhe neutral për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore që përjashton përdorimin e vlerave doganore arbitrare ose fiktive. Në të vërtetë, Kodi Doganor përcakton metodologjinë e vlerësimit që Dogana e Kosovës duhet të aplikojë në importe.

1.1 Metodatat e vlerësimit të mallit

Vlera e Transaksionit të mallit është Metoda e parë e vlerësimit të mallit -neni 33 i KDA-se parasheh se, Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37, me kusht që: -Neni 34 parasheh se kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë).

Vlera e transaksionit të mallrave identike-Vlera e transaksionit të mallrave identike të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë, ose përafërsisht, në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar.

Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme-Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport për Kosovë dhe të eksportuara në të njëjtën kohë ose përafërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar.

Metoda e vlerësimit të deduktuar (bazuar për çmimin për njësi) Vlera e bazuar në çmimin për njësi, në të cilin mallrat e importuara që korrespondojnë me mallrat identike ose të ngjashme të importuara dhe të shitura brenda Kosovës, në sasi të përgjithshme më të madhe, personave që nuk janë në lidhje me shitësin.

-Metoda e vlerësimit të përlogaritur-Vlera e llogaritur, e cila është dhe metoda më e vështirë, përcakton vlerën doganore në bazë të kostos së prodhimit të mallrave që vlerësohen, duke shtuar fitim dhe shpenzime të përgjithshme që zakonisht reflektohen në shitjet nga vendi i eksportit në vendin e importimit të mallrave të të njëjtit klasë ose lloji.

-Të Dhënave të Disponueshme (Neni 35) Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, dotë përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme.

Në masën më të madhe të mundshme, "vlera doganore" e mallrave të importuara do të jetë vlera e transaksionit të mallrave që vlerësohen. Vlera e transaksionit të mallrave është e bazuar kryesisht në çmimin e paguar ose të pagueshëm për mallrat (në përputhje me realitetin komercial) përveç në rastet kur disa kufizime ose kushte që kanë të bëjnë me mallrat, padrejtësisht ose në mënyrë jorealiste ndikojnë në vlerën e tyre. Vlerat doganore janë të bazuara në kritere të thjeshta dhe të barabarta në përputhje me praktikën tregtare dhe metodat e zbatuara të vlerësimit duhet të jenë "të aplikimit të përgjithshëm, pa dallim në mes të burimeve të furnizimit".

Importuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se vlera doganore nuk mund të përcaktohet në bazë të: çmimit të shitjes në Kosovë të mallrave të prodhuara në Kosovë, një sistemi i cili siguron pranimin për qëllime doganore të më të lartës nga dy vlerat alternative, çmimit të mallrave në tregun e brendshëm të vendit eksportues, kostos së prodhimit, të ndryshme nga vlerat e përlogaritura që janë përcaktuar për mallra identike ose të ngjashme, në pajtim me nenin 33 (2) (d); çmimet për eksport në një vend tjetër jashtë Kosovës, Vlerave doganore minimale ose Vlerave arbitrare ose fiktive. MVD-OBT gjithashtu pranon se procedurat e vlerësimit doganor nuk duhet të përdoren për të luftuar dumpingun. Në këtë drejtim, çdo sistem i aplikimit të vlerave minimale ose krahasuese, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet e MVD-së, parimet e BE-së dhe dispozitat e vlerësimit të importit në Kodin Doganor të Kosovës.¹

Neni 69 i UA 11/2009 parasheh se në aplikimin të nenit 34.2 (a) të Kodit (vlera e transaksionit të mallrave identike), vlera doganore duhet të përcaktohet duke u referuar te vlera e transaksionit të mallrave identike në shitje në të njëjtin nivel komercial dhe në sasi të njëjtë sikurse mallrat që janë duke u vlerësuar. Kur nuk është e mundur të gjendet shitje e tillë, vlera e transaksionit për mallrat identike të shitura në nivel të ndryshëm komercial dhe/ ose në sasi të ndryshme të përshtatur për të marrë parasysh nivelet e ndryshme komercial dhe/ose në sasi të ndryshme, shfrytëzohet me kusht që përshtatjet e tilla të mund të bëhen mbi bazat e dëshmisë së provuar, e cila pa dyshim krijon arsyeshmërinë dhe saktësinë e përshtatjes, qoftë nëse kjo shpie në rritje apo zvogëlim të vlerës. Kur kostot dhe pagesat e referuara në nenin 36.1 (e) të Kodit janë përfshirë në vlerën e transaksionit, atëherë përshtatja duhet të bëhet duke marrë parasysh ndryshimet e domosdoshme në kostot e tilla apo pagesat ndërmjet mallrave të importuara dhe mallrave identike në fjalë që janë rrjedhojë e ndryshimeve të tilla të distancave dhe të formave të transportit. Nëse, në aplikimin e këtij Neni, konstatohet se ekzistojnë më shumë se një vlerë e transaksionit të mallrave identike, duhet të merret vlera më e ulët, për të përcaktuar vlerën doganore të mallrave të importuara.

Vlera doganore duhet të përcaktohet duke u referuar në vlerën e transaksionit të mallrave të ngjashme (Neni 70 i UA 09/2011 lidhur me nenin 34.2 (b) të KDA-se) në shitje në të njëjtin nivel komercial dhe kryesisht në sasi të njëjtë sikurse mallrat që janë duke u vlerësuar. Kur nuk është e mundur të gjendet shitje e tillë, atëherë duhet të shfrytëzohet vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura në nivel të ndryshëm komercial dhe/ ose sasi të ndryshme të përshtatur për të marrë parasysh atributet e ndryshme të nivelit komercial dhe/ ose sasi të, shfrytëzohet me kusht që përshtatjet e tilla të mund të bëhen mbi bazat e dëshmisë së provuar, e cila pa dyshim krijon arsyeshmërinë dhe saktësinë e përshtatjes, nëse përshtatja shpie kah rritja apo zvogëlimi i vlerës. Nëse, as mallrat e importuara as mallrat identike e as të ngjashëm të importuara, nuk janë shitur në kohën apo periudhë të afërt kohore, kur importohet malli vlera e të cilit përcaktohet, vlera doganore e mallit të importuar e caktuar sipas këtij Neni, e cila nuk i nënshtrohet dispozitave e paragrafit 1, të bazohet në çmimin për njësi, sipas të cilit mallrat e importuara apo identike apo të ngjashme janë shitur në Kosovë në kushtet sikur janë importuar në datën e mëhershme pas importimit të mallrave, që janë vlerësuar por para kalimit të 90 ditëve pas importimit të tillë.²

Neni 35 I KDA-se parasheh se Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet

¹ Kodi Doganor dhe i Akcizave Nr. 03/L-109 (Nëntor 2008).

² Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 Nenet 60-82 të këtij Udhëzimi Administrativ (pp 18-51) ofrojnë informacion të detajuar mbi vlerësimin doganor, dhe Aneksi 12 i Udhëzimit Administrativ përshkruan "Shënimet Shpjeguese mbi Vlerën Doganore" që janë të dobishme. (Ky aneks gjendet në faqen 377 të Udhëzimit Administrativ).

në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme: - Marrëveshjen për implementimin e Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994; - Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994; Në rastet kur zbatohet paragrafi 1 asnjë vlerë doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën e: Çmimit të shitjes së mallrave të prodhuara në Kosovë; Një sistemi i cili për qëllime doganore parashikon pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative; Çmimit të mallrave në tregun vendor të vendit eksportues; d) Kostos së ndryshme të prodhimit nga vlerat e përllogaritura që janë përcaktuar për mallra identike apo të ngjashme në përputhje me nenin 33 (2) (d); Çmimeve për eksport në një vend tjetër nga ai i Kosovës; f) Vlerave doganore minimale ose g) Vlerave arbitrare ose fiktive.

Kurdo që Dogana e Kosovës ka dyshime në lidhje me një vlerë të deklaruar të importit, një zyrtar doganor mund të kërkojë informacione shtesë mbi mallrat dhe transaksionet në fjalë. Megjithatë, në qoftë se vazhdon dyshimi, oficeri duhet, para se të arrijë një vendim përfundimtar, të njofton personin në fjalë, me shkrim nëse kërkohet, me arsyet e këtyre dyshimeve dhe t'i sigurojë personit një mundësi të arsyeshme për t'u përgjigjur. Në të gjitha rastet e tilla, vendimi përfundimtar dhe arsyet duhet t'i komunikohen me shkrim personit në fjalë. Kur një borxh doganor lind në lidhje me mallrat e importuara dhe vlera doganore e këtyre mallrave bazohet në çmimin realisht të paguar ose të pagueshëm që përfshin shpenzimet e magazinimit dhe të ruajtjes së mallrave gjatë vendosjes së tyre në magazinë, këto shpenzime nuk duhet të përfshihen në vlerën doganore në rast se tregohen veçmas nga çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat.

Aty ku është e nevojshme për të krijuar një vlerë doganore për qëllime të neneve 32-40 të Kodit Doganor, një deklaratë e të dhënave në lidhje me vlerën doganore të mallrave të importuara (deklarata e vlerës) është e nevojshme të shoqërojë deklaratën doganore të importit të bërë në lidhje me mallrat e importuara. Deklarata e vlerës do të plotësohet dhe paraqitet në formularin "DV 1" që korrespondon me modelin në Aneksin 14 të "Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 që përcakton dispozitat për zbatimin e Kodit Doganor" që plotësohet, kur është e përshtatshme nga një ose më shumë formularë DV 1 që korrespondojnë me modelin në Aneksin 15, gjithashtu të Udhëzimit Administrativ të njëjtë. Kjo deklaratë e vlerës mund të bëhet vetëm nga një person i vendosur në Kosovë dhe në posedim të fakteve relevante. Dogana e Kosovës mund të heq dorë nga kërkesa për një deklaratë të ndarë të vlerës, kur vlera doganore e mallrave në fjalë nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të nenit 33 të Kodit. Në raste të tilla personi përgjegjës në Kosovë do t'i pajisë ose të shkaktojë pajisjen e Doganës së Kosovës me ato informata tjera që mund të kërkohen për qëllime të përcaktimit të vlerës doganore në bazë të një neni tjetër të Kodit; dhe këto informacione të tjera do të ofrohen në formën dhe mënyrën që do të përcaktohet nga Dogana e Kosovës.

Programet Softuerike nuk i nënshtrohen taksës doganore dhe taksës së TVSH-së, me kusht që vlera e softuerit të jetë e ndarë në faturë nga vlera e instrumentit, i cili është bartës i softuerit (nuk duhet të prezantohet Deklarata Unike Doganore) Vetëm vlera e instrumentit bartës do t'i nënshtrohet taksës doganore dhe taksës së TVSH-së. Në rast se vlera e softuerit i është bashkangjitur vlerës së instrumentit bartës (kemi vetëm një çmim të përbashkët), atëherë nga aspekti doganor e tërë vlera do t'i nënshtrohet taksës doganore dhe taksës së TVSH-së.

I.1 Shpenzimet e Transportit

Dispozitat në lidhje me shpenzimet e transportit neni 84 UA nr. 11/200, në aplikim të nenit 36.1 (e) dhe 37.1 (a) të Kodit:(a) kur mallrat transportohen me të njëjtën mënyrë transporti deri në një pikë, që

ndodhet përtej vendit të hyrjes në territorin doganor të Kosovës, shpenzimet e transportit vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me largësinë e përshkruar jashtë dhe brenda territorit doganor të Kosovës, duke përjashtuar rastet kur doganës i jepet provë mbi shpenzimet që do të ishin bërë në përputhje me tarifën, zakonishtme që zbatohet për transportin e mallrave deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Kosovës; (b) kur mallrat janë faturuar me një çmim të vetëm deri në mbërritjen në destinacion, I cili i përgjigjet çmimit deri në vendin e hyrjes në Kosovë, shpenzimet e transportit brenda Kosovës nuk zbriten nga ky çmim. Megjithatë, kjo zbritje lejohet me kusht që t'i provohet Doganës se çmimi franko - kufi, është më i ulët sesa çmimi i njëjtë franko - destinacion. (c) kur transporti është falas ose kur e siguron blerësi, shpenzimet e transportit deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Kosovës, të përlogaritur në bazë të tarifave të 50 obligueshme mbi transportin, të cilat zakonisht aplikohen me të njëjtat metoda të transportit, hyjnë në vlerën doganore.³

Nenit 36 të KDA-së Për përcaktimin e vlerës doganore në bazë të nenit 33, çmimit vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e importuar duhet shtuar: a) Elementet e mëposhtme, deri në masën që ato kanë ngarkuar blerësin por nuk janë përfshirë në çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat: (i) komisionet dhe ndërmjetësimet e mëvonshme, me përjashtim të komisioneve të blerjes; (ii) kostoja e kontejnerëve, të cilat për qëllime doganore, trajtohen si një tërësi e vetme me mallrat në fjalë; (iii) kostoja e ambalazhimit, qoftë për punë apo materialet; b) Vlera e përpjesëtuar si e përshtatshme e mallrave dhe shërbimeve në vijim, kur këto mallra furnizohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga blerësi, pa pagesë ose me pagesë të reduktuar, për t'u përdorë në produktin dhe për shitjen për eksport të mallrave të importuara në atë masë që kjo vlerë nuk është përfshirë në çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm: (i) materiale, pjesë përbërëse, pjesë dhe artikuj të ngjashëm të inkorporuar në mallrat e importuara, (ii) vegla, matrica, kallëpe e artikuj të ngjashëm të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara, (iii) materiale të konsumuara për prodhimin e mallrave të importuara, (iv) puna inxhinierike, zhvilluese, punimet artistike, dizajnimi, puna projektuese dhe skicimet e kryera jashtë vendit dhe të nevojshme për prodhimin e mallrave të importuara; c) Pagesat për të drejtën e autorit-pronësisë intelektuale dhe pagesat për të drejtën e licencës, që lidhen me mallrat që po vlerësohen, që blerësi duhet t'i paguajë drejtpërdrejt apo tërthorazi, si kusht i shitjes së mallrave që po vlerësohen deri në atë masë, që ato pagesa nuk janë përfshirë në çmimin vërtetë të paguar apo të pagueshëm; d) Vlera e çdo pjese të fitimit nga çdo rishitje, tjetërsimi apo përdorimi i mëvonshëm i mallrave të importuara që i ngarkohet drejtpërdrejt apo tërthorazi shitësit; e) (i) shpenzimet e transportit dhe sigurimit për mallrat e importuara dhe (ii) shpenzimet e ngarkimit dhe trajtimit lidhur me transportimin e mallrave të importuara deri në vendin e paraqitjes së tyre në Kosovë.

Lidhur me lartësinë e shpenzimeve të transportit nga shitësi deri tek blerësi, zyrtarët doganor duhet të marrin për bazë kushtet e përgjithshme të dërgesës, respektivisht kontratës së lidhur në mes dyja palëve ku në mënyrë të detajuar duhet të përshkruhen obligimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese ashtu siç janë të rregulluara në tregtinë ndërkombëtare përmes termave mbi paritetet – Incoterms 2010.

3. Elementet që duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të një Deklarate Unike Doganore lidhur me paritetin janë si në vijim:

3.1. çmimi i mallit për njësi;

3.2. natyra dhe specifikat e mallit;

3.3. origjina e mallit;

3.4. dokumentet e bashkangjitura (kontrata, fatura, mënyra e pagesës dhe dëshmi të ngjajshme).

³ Kodi Doganor dhe i Akcizave Nr. 03/L-109 (Nëntor 2008).

Kur gjatë deklarimit të mallrave, kontestohet ndonjëra nga komponentët e vlerës së mallit, duke filluar nga pariteti, çmimi i mallit, shpenzimet e transportit, sigurimit apo shpenzimet tjera, duhet të ndryshohet metoda e vlerësimit. Edhe në rastet kur vlera faturale e mallit mbetet e paprekur por kontestohen shpenzimet e transportit, respektivisht pariteti, duhet doemos të kalohet nga metoda parë e vlerësimit në metoda tjera sipas rastit dhe në raste të tilla zyrtarët dognor duhet lëshuar procesverbal për konstatimin e gjendjes faktike në kuptim të vlerës.

Transporti rrugor-Gjatë kalkulimit të shpenzimeve të transportit rrugor duhet përdorur kriteri i largësisë shprehur në kilometra dhe çmimit 1.50 €/km duke iu shtuar shuma fillestare prej 200 € si një shumë ku përfshihen: shpenzimet e amortizimit e mirëmbajtjes së mjetit të transportit, taksat rrugore, vonesat, taksat e terminaleve, mëditjet e vozitësit, dhe të ngjajshme dhe kësaj shume i shtohen kilometrat deri në kufirin e Kosovës. Rastet kur dërgesat vijjnë nga portet e ndryshme në shpenzimet e transportit kalkulohet edhe shuma fikse prej 250 €; Tek automjetet me pajisje ftohëse po ashtu edhe tek transporti special, vlerës së kalkuluar të shpenzimeve i shtohet edhe 20% e shpenzimeve totale. Rastet kur transporti kryhet me mjete vetanake të transportit por gjithnjë duke plotësuar kushtet si në vijim:

- 2.1 automjeti të jetë i regjistruar në emër të kompanisë importuese (libreza e qarkullimit të automjetit);
- 2.2. prezentimi i kontratës së punës ndërmjet vozitësit dhe kompanisë;
- 2.3 zbritja mund të bëhet jo më tepër se 30% nga tarifa normale e shpenzimeve.

Këto tarifa do të aplikohen vetëm atëherë kur subjektet importuese bëjnë deklarime dukshëm më të ulëta të shpenzimeve të transportit apo nuk janë në gjendje të dokumentojnë paritetin e deklaruar. Të gjitha ato subjekte që nuk pajtohen me këtë metodë të kalkulimit të shpenzimeve të transportit janë të obliguara që me dokumente valide të dëshmojnë të kundërtën. Formula e llogaritjes së shpenzimeve është e paraqitur në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi dhe është si në vijim: $SHT = km * 1.5€ + 200€ (+250€)$ ⁴

II. KLASIFIKIMI I MALLRAVE SIPAS TARIK-UT-TARIFA DOGANORE E KOSOVËS DHE KLASIFIKIMI TARIFOR I MALLRAVE

Neni 24 I KDA-se parasheh se detyrimet e importit për t'u paguar ligjshmërisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, ku hyn edhe Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor. Masat e tjera të parashikuara nga ligjet e zbatueshme në Kosovë që aplikohen për importimin dhe eksportimin e mallrave do të zbatohen, kur është e nevojshme, sipas klasifikimit tarifor të këtyre mallrave përbrenda TARIK-ut. TARIK-u përfshin: Nomenklaturën e mallrave ligjërisht të detyrueshme, bazuar në Konventën Ndërkombëtare mbi Sistemin e Harmonizuar të Përshkrimit të artikujve dhe Kodimit dhe Nomenklaturën e Kombinuar të Unionit Evropian; Ligjet e Kosovës të shënuara me poshtë dhe marrëveshjet në të cilat ka hyrë Kosova, të cilat janë në TARIK vetëm për qëllime të lehtësimit të referencave:

Cilido ligj i Kosovës i cili parasheh shkallët e detyrimeve doganore, taksave dhe formave tjera të detyrimeve që zbatohen normalisht mbi mallrat e përfshira në TARIK; Çdo masë tarifore preferenciale e përfshirë në Marrëveshjet e Tregtisë Preferenciale që Kosova ka bërë me vendet e

⁴ Udhëzim Administrativ (Qrk) Nr. 04/2014 Për Përcaktimin E Kostos Së Shpenzimeve Të Transportit Të Mallrave Të Importuara

caktuara apo me grupe vendesh dhe të cilat parashohin subvencion/lejim për trajtim preferencial tarifor; Çdo masë sipas ligjeve të Kosovës që parasheh reduktimin apo përjashtimin nga detyrimet e importit që duhet paguar për mallrat e caktuara dhe Masa tjera tarifore të parashikuara me legjislacionin tjetër të Kosovës.

Masat e përmendura në kryeradhën e dytë dhe të tretë të paragrafit 3 (2) do të zbatohen me kërkesë deklaruesit në vend të atyre të parapara në kryeradhën e parë të paragrafit 3 (2), ku mallrat përkatëse plotësojnë kushtet e parapara nga masat e parapara fillimisht. Më pas mund të paraqitet kërkesa me kusht që të plotësohen kushtet relevante. Kur zbatimi i masave të përmendura në kryeradhën e dytë dhe të tretë të paragrafit 3 (2) kufizohet në një vëllim të caktuar importesh, pushon te vlejë: Në raste të kuotave (kontingjenteve) tariforë, pos kur arrihet limiti i përcaktuar në vëllimin e importeve; Në raste të kufijve tarifor, sipas vendimit të autoritetit kompetent.

2.1. Dokumentacioni i nevojshem për Origjinën e mallit

Klasifikimi tarifor i mallrave në nomenklaturën e mallrave në TARIK do të përcaktohet sipas rregullave të përgjithshme për interpretim të nomenklaturës së mallrave, siç është publikuar në nomenklaturën e kombinuar të Unionit Evropian, shënimet shtesë të TARIK-ut dhe Direktivës për interpretim të nomenklaturës së mallrave në TARIK, që përbehet nga shënimet sqaruese të sistemit të harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave dhe të shënimeve sqaruese për Nomenklaturën e Kombinuar të Unionit Evropian. Trajtimi tarifor favorizues prej të cilit mund të përfitojnë disa mallra për shkak të natyrës së tyre ose të përdorimit të tyre të veçantë, i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ në zbatim të këtij Kodi. Kur kërkohet autorizim, zbatohen nenet 90 dhe 91. Për qëllim të paragrafit 1, shprehja “trajtim tarifor favorizues” nënkupton reduktimin ose pezullimin e një detyrimi doganor siç përmendet në nenin 4 (10), qoftë kjo edhe në kuadrin e një kuote tarifore.⁵ **(BTI-INFORMAT E OBLIGUAR TARIFORE).**

Kodi Doganor i Kosovës jep autoritetin për metodat që duhet të zbatohen në përcaktimin e përshkrimit (klasifikimit) të mallrave të importuara dhe të eksportuara. [shih nenet 24 dhe 25 të Kodit Doganor]. Në përmbledhje, Kodi Doganor parasheh se: Detyrimet e importit që duhet paguar kur një "borxh doganor" lind do të bazohen në nomenklaturën e mallrave të TARIK-ut, tarifës doganore të Kosovës, ligjet e zbatueshme në Kosovë dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh, e lidhur nga Kosova që parasheh dhënien e trajtimit tarifor preferencial. Çdo masë tjetër në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë që aplikohet për importimin ose eksportimin e mallrave, atëherë kur është e përshtatshme, do të zbatohet në bazë të klasifikimit tarifor të këtyre mallrave përbrenda TARIK-ut.

Tarifa doganore e Kosovës është e bazuar në Përshkrimin e Mallrave të Harmonizuar Ndërkombëtarisht dhe Sistemin i Kodimit të cilit përgjithësisht i referohet si "Sistemi i Harmonizuar" dhe nomenklaturën ndërkombëtare e produkteve me qëllime të shumëfishta e zhvilluar dhe e administruar nga Organizata Botërore e Doganave (OBD). Sistemi i Harmonizuar përmban më shumë se 5000 grupe mallrash, secili i identifikuar nga një nëntitull ndërkombëtar gjashtë-shifror, të organizuar në një strukturë ligjore dhe logjike dhe mbështetur nga rregulla të përcaktuara mirë për të arritur klasifikime uniforme. Sistemi përdoret nga më shumë se 200 vende dhe ekonomi si bazë për tarifatat doganore të tyre dhe për mbledhjen e statistikave të tregtisë ndërkombëtare.

Mbi 98% e mallrave në tregtinë botërore klasifikohet sipas interpretimi zyrtar i është dhënë në pesë vëllime të Shënimeve Sqaruese, të publikuara nga OBD, si pjesë e një database të mallrave duke u

⁵ Neni 24 i Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës

dhënë klasifikimin më shumë se 200.000 mallrave të tregtuara ndërkombëtarisht. Vendimet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Sistemit të Harmonizuar, siç janë vendimet për klasifikim dhe ndryshimi i Shënimeve Sqaruese ose i përmbledhjes së opinioneve të klasifikimit. Hyjnë në fuqi dy muaj pas miratimit nga Komiteti i OBD-së. TARIK-U NË KOSOVË. Kosova miratoi Sistemi i Harmonizuar si bazë për “TARIK-un” e Doganës së Kosovës në vitin 2005 dhe do të vazhdojë të përdorë Sistemi i Harmonizuar pasi që TARIK-u është i integruar eventualisht me tarifën e jashtme të bazuar në BE.

TARIK-u përbën një plan të normave dhe masave që zbatohen për importimin dhe eksportimin e mallrave; nën-titulli ndërkombëtar gjashtë-shifror rafinohet më tej me katër shifra tjera shtesë për të marrë parasysh të gjitha kërkesat për Entin Statistikor të Kosovës, detyrimet doganore, masat e politikës tregtare për importit dhe eksport, norma preferenciale të detyrimeve (CEFTA), TVSH-në dhe normat e akcizës. TARIK-u është pika e përbashkët e referencës për tregtarët, agjentët doganore, Doganën e Kosovës dhe të gjitha ministritë përkatëse dhe kështu siguron zbatimin uniform të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për import dhe eksport. TARIK-u është përditësuar për të marrë parasysh të gjitha rregulloret e miratuara rishtazi dhe përditësohet në baza vjetore në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Evropian, të publikuar. Nomenklatura e harmonizuar e mallrave dhe sistemit të kodimi Kodi i mallit për import është një numër dhjetë shifror që barazohet me një përshkrim të artikullit. Çdo artikull do të ketë një numër kodi - megjithatë të ndryshëm ose të panjohur.

Ndaj çdo kodi të mallit është vendosur një normë detyrimi, siç cilido kufizim ka të ngjarë të zbatohet mund të nevojitet edhe Licenca p. sh. DTI për import. Klasifikimin e produkteve tuaja sipas kodeve të duhura të mallrave është shumë e rëndësishme pasi që kodi; Përshkruan mallrat dhe Përcakton normën e detyrimit. Shumica e produkteve të importuara do të tërheqë detyrime. Është e rëndësishme që të paguhet norma e saktë e detyrimit. Nëse paguani shumë, do të jeni në disavantazh financiarisht. Nëse paguani shumë pak, ka të ngjarë që do të ju duhet paguani shumë shtesë më vonë, ndoshta pasi ti keni shitur mallrat. Sigurimi se produktet tuaja klasifikohen sipas kodit të saktë të mallrave është shumë me rëndësi. Kodet e mallrave janë të përfshira në Volumin 2 të Tarifës dhe ka diku 65.000 të tillë. Tarifa përditësohet çdo muaj siç edhe kodet mund të ndryshojnë, të largohen ose të shtohen të reja.⁶

Tarifa doganore për Kosovë, e cila bazohet në Sistemin e harmonizuar, zbatohet me importimin e mallrave për në Kosovë dhe me eksportimin e mallrave nga Kosova, ashtu siç janë përkufizuar këto koncepte në nenin 2. Bazuar në nenin e lartcekur, Tarifa doganore e Kosovës e cila është e bazuar në nomenklaturën e harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave, zbatohet vetëm me rastin e importimit të mallrave për në Kosovë, përkatësisht eksportimin e mallrave nga Kosova. Nga kjo mund të thuhet se shërbimet e ndryshme që realizojnë subjektet afariste nuk mund të përfshihen në tarifën e integruar të Kosovës dhe si të tilla, nuk mund t’iu nënshtrohen asnjë lloj procedure doganore dhe takse në import apo eksport.

II.2 Lirimi nga taksat te Mallrave sipas tarikut dhe KDA-se

Neni 16 Dispozita të veçanta 16.6 (a) Pavarësisht nga nenet 13 deri në 15, në caktimin e vlerës së instrumenteve të importuara bartëse që përmbajnë të dhëna apo instruksione që përdoren në pajisjet e përpunimit e të dhënave, vetëm kostoja apo vlera e vet instrumentit bartës do të merret parasysh. Prandaj, vlera e instrumentit bartës të importuar që sjell të dhëna apo instruksione, nuk do të përfshijë

⁶ <https://itg-rks.com/wp-content/uploads/2018/12/TARIK-shqip>.

koston apo vlerën e të dhënave apo instruksioneve, me kusht që ajo kosto apo vlerë të jetë e veçuar nga kostoja apo vlera e instrumentit bartës në fjalë. 'instrumentet bartëse' nuk përfshijnë qarqet e integruara gjysmëpërçuesit dhe mekanizmat apo artikujt e ngjashëm, që inkorporojnë qarqe apo mekanizma të tilla dhe(II) 'të dhënat ose instruksionet' nuk përfshijnë pajisjet për incizim të zërit, incizimet filmikë ose videoincizuesit. Trajtimi i softuerëve nga aspekti doganor trajtohet kryesisht sipas vështrimit të nenit 16.6 të Kodit Doganor (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/1), që nënkupton se:

Programet Softuerike nuk i nënshtrohen taksës doganore dhe taksës së TVSH-së, me kusht që vlera e softuerit të jetë e ndarë në faturë nga vlera e instrumentit, i cili është bartës i softuerit (nuk duhet të prezantohet Deklarata Unike Doganore) Vetëm vlera e instrumentit bartës do t'i nënshtrohet taksës doganore dhe taksës së TVSH-së. Në rast se vlera e softuerit i është bashkangjitur vlerës së instrumentit bartës (kemi vetëm një çmim të përbashkët), atëherë nga aspekti doganor e tërë vlera do t'inënshtrohet taksës doganore dhe taksës së TVSH-së.⁷

III. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DOGANORE

Neni 274 I KDA-se -parasheh se personi juridik apo fizik: a) Në qoftë se, Doganës nuk ia paraqesin mallrat narkotike apo lënda për prodhimin ose përpunimin e tyre. b) Në qoftë se, Doganës nuk ia paraqesin armët, mjetet shpërthyesë dhe eksplozivët. c). Në qoftë se, Doganës nuk ia paraqesin materialet e rrezikshme apo çdo mall i cili është i ndaluar për t'u importuar ose eksportuar me legjislacionin, që është në fuqi në Kosovë, do te gjobiten me te holla ne shume prej pesëmijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) €. (Neni 275) Personi juridik apo fizik: a). Në qoftë se, e sjellë apo e nxjerrë në mënyrë të paautorizuar në Kosovë, përkatësisht tenton ta sjellë ose ta nxjerrë mallin, në mënyrë të paautorizuar jashtë Kosovës, pas orarit të punës së zyrës përkatëse doganore. b). Në qoftë se, e sjellë apo tenton ta sjellë mallin, në mënyrë të fshehur në Kosovë, përkatësisht e nxjerrë apo tenton ta nxjerrë mallin, në mënyrë të fshehur jashtë Kosovës, c). Në qoftë se, nuk i paraqet të mirat kulturore apo natyrore, të cilat i sjellë apo i nxjerrë jashtë Kosovës, do të gjobitet me të holla në shume prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €.

Neni 276 i KDA-se ne mënyrë taksative parasheh se: Personi juridik apo fizik:

- a). Në qoftë se, nuk e paraqet mallin:
- b). Në qoftë se, nuk e parashton brenda afatit ligjor deklaratën përmbledhëse.
- c). Në qoftë se, e shkarkon ose e ringarkon mallin pa pëlqimin e Doganës ose në vendin që nuk është caktuar apo lejuar për atë qëllim.
- d). Në qoftë se, nuk e transporton mallin e sjellë rrugëve dhe në mënyrën e caktuar sipas autorizimeve të Doganës.
- e). Në qoftë se, e zhvendosë mallin nga vendi i caktuar pa pëlqimin e Doganës.
- f). Në qoftë se, mallin e strehuar përkohësisht e përdorë në kundërshtim me kushtet e lejuara nga Dogana ,
- g). Në qoftë se, në procedurën e transitit nuk ia dorëzon mallin dhe dokumentet përcjellëse Doganës destinuese në përputhje me dispozitat për atë procedurë.
- h).Në qoftë se, Doganës nuk i ofron dokumentet, shënimet dhe sqarimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave doganore,
- i). Në qoftë se, nuk i ruan dokumentet dhe shënimet në pajtim me afatin e caktuar me nenin 22 te këtij Kodi.
- j). Në qoftë se nuk e parashton Deklaratën Unike Doganore për trajtim apo përdorimin e lejuar

⁷ KDA, UA 09/2011,

doganor në pajtim me afatet e parapara me këtë Kod.

k). Në qoftë se, në Deklaratën Unike Doganore në mënyrë të rrejshme, të pasaktë apo jo të plotë shënon sasinë, cilësinë, llojin, kodin tarifor, vlerën apo origjinën e mallit ose nuk e përfshin tërë mallin, që ka rezultuar me llogaritjen ose pagesën e borxhit doganor në shumë më të vogël nga ajo reale.

l). Në qoftë se, në dokumentet e bashkangjitura deklaratës doganore për zbatimin e procedurës doganore, është shënuar sasia, lloji, cilësia, vlera apo origjina tjetër e mallit.

m). Në qoftë se, me paraqitjen e rreme të fakteve realizon apo tenton të realizojë lirimin nga pagesa e detyrimeve të importit ose aplikimin e detyrimeve më të volitshme të importit,

n). Në qoftë se, e pengon verifikimin e deklaratës së pranuar nga Dogana .

o). Në qoftë se, e përdor apo disponon me mallin para se Dogana të lejojë procedurën e kërkuar doganore.

p). Në qoftë se, i largon, i dëmton ose i asgjëson shenjat doganore.

q). Në qoftë se, nuk e parashton deklaratën plotësuese doganore brenda afatit të caktuar.

r). Në qoftë se, për mallin nuk e mban evidencën e rregullt të paraparë për procedurën e caktuar doganore apo për formën tjetër të trajtimit apo përdorimit të lejuar doganor.

s). Në qoftë se, nuk e lajmëron autoritetin doganor mbi rrethanat e krijuara pas marrjes së autorizimit për regjimet pezulluese apo për Procedurë doganore me ndikim ekonomik.

t). Në qoftë se, mallin e liruar nga pagesa e detyrimeve importuese ose të lëshuar me pagesën e detyrimeve më të volitshme, para skadimit të afatit të caktuar, e shet, huazon, ia jep tjetërkujt në përdorim, e deponon për peng ose jep në qesim, ose si sigurim për ndonjë detyrim tjetër, para se të përmbushë borxhin doganor.

u). Në qoftë se, disponon me mallin para pagesës së borxhit të lindur doganor.

v). Në qoftë se, nuk vepron në përputhje me kushtet dhe obligimet e përcaktuara dhe autorizimet e Doganës për regjim doganor me pezullim dhe Procedurë doganore me ndikim ekonomik.

w). Në qoftë se, pamundëson mbikëqyrjen doganore të afarizmit në zonën e lirë ose në depon e lirëdoganore.

x). Në qoftë se, në zonën e lirë ose depon e lirë doganore ushtron veprimtarinë në kundërshtim me legjislacionin doganor ose pa pëlqimin e autoritetit doganor,

y). Në qoftë se, për mallin importi i të cilit është i ndaluar nuk e largon nga Kosova brenda afatit të caktuar nga Dogana .

z). Në qoftë se, me paraqitjen e rreme të fakteve realizon apo tenton të realizojë kthimin apo shuarjen e borxhit doganor, do të gjobitet me gjobë në të holla në shumë prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) €.

Çdokush që e pranon mallin për të cilin e ka ditur, apo nga rrethanat e rastit, ka mund të dijë se më të është kryer kundërvajtje nga neni 275, 276 dhe 277 të këtij Kodi, do të gjobitet, sikur vetë ta kishte kryer kundërvajtjen, më të njëjtën gjobë të përcaktuar për kryesin e kundërvajtjes.

III. 1 PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE SIPAS KDA-se

A. Procedura Mandatore

Kur vlera e mallit nuk kalon 500.-€, do të gjobitet personi fizik me të holla në shumë prej 100.-€ për kundërvajtje administrative, të paraparë me nenin 277 të këtij Kodi. Dogana ku është bërë shkelja e shqipton dhe e inkason gjobën e shqiptuar nga paragrafi 1. Në qoftë se, kryesi i kundërvajtjes refuzon të paguajë gjobën, kundër tij, do të iniciohet procedura e rregullt kundërvajtëse (Neni 278 i KDA-së).

B. Procedura e Rregullt

Çdo shkelje administrative tjetër, të parapara me nenin 279, do të jenë objekt i procedurës së rregullt, e cila do t'i iniciohet prej Doganës, ku është bërë shkelja administrative me procesverbal zyrtar. Procedura zhvillohet pranë Sektorit për kundërvajtje doganore në Doganë, vendimi do të merret sipas nenit 12 të këtij Kodi⁸. Malli i cili është objekt i shkeljes administrative nga neni 275, 276 a), b) dhe 278 do të konfiskohet. Malli i cili është objekt i shkeljes administrative nga neni 276 c) dhe 278 mund të konfiskohet. Malli që është objekt i shkeljes administrative doganore, do të konfiskohet edhe në qoftë se është pronë e kryesit të kundërvajtjes doganore, i cili është i paarritshëm apo në qoftë se kryesi i kundërvajtjes është i panjohur.

Nëse, malli nuk mund të konfiskohet, Dogana, do të inkasojë një vlerë të baras vlefshme me vlerën doganore të mallit, të ngritur për detyrimet doganore të importit nga kryesi i shkeljes administrative doganore. Kryesit e shkeljeve administrative doganore do të përgjigjen në mënyrë individuale dhe solidare, për shumën e parapare me paragrafin. Mjeti bartës apo transportues, hapësirat e fshehta, të cilin janë shfrytëzuar për bartjen, përkatësisht transportimin e mallit, në territorin e Kosovës dhe është objekt i kundërvajtjes nga neni 275 dhe 276 të këtij Kodi, mund të konfiskohet, nëse vlera e mallit që është objekt i kundërvajtjeve e tejkalon një të tretën e vlerës së automjetit bartës apo transportues. Mjeti bartës apo transportues, i cili është përdor për bartjen e mallit nga neni 275 dhe 276 të këtij Kodi ose mjeti bartës apo transportues, në të cilin është krijuar hapësire e veçantë për fshehjen e mallit, mund të konfiskohet edhe nëse vlera e mallit nuk e tejkalon 1/3 e vlerës së automjetit. Mjeti bartës apo transportues mund të konfiskohet edhe në qoftë se nuk është pronë e kryesit të kundërvajtjes, në qoftë se pronari i tij e ka ditur apo ka mund të dijë se ai është përdor për kryerjen e kundërvajtjes nga neni 275. ose 276. të këtij Kodi.

Malli i cili është objekt i konfiskimit sipas dispozitave tjera në fuqi, mund të ndalet deri në përfundimin të kesaj procedure përkatëse. Malli që është objekt i shkeljes administrative doganore, për të cilin është parapare konfiskimi i mallit, do të ndalet deri në përfundimin e procedurës kundërvajtëse. Dogana mund, në raste të arsyeshme, pas deponimit të garancionit në shumën e vlerës së mallit të ndaluar, atë ta vendosë te personi përkatës me paralajmërim se mallin nuk guxon ta përdorë, ta shesë, apo të disponojë me mallin, në mënyrë tjetër. Me rastin e ndalimit të mallit përpilohet procesverbali me përshkrimin e hollësishëm të mallit.

Një ekzemplar i këtij procesverbali dhe vërtetimin mbi pranimin e mallit, Dogana duhet t'ia dorëzojë personit, të cilit i është ndaluar malli. Dogana mund, deri në përfundimin e procedurës doganore, ta ndalojë mallin i cili nuk është përfshirë në paragrafin 2 të këtij neni, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm, se malli ka qene i përdorur ose i destinuar për kryerjen e shkeljes administrative, përkatësisht është siguruar me shkelje administrative doganore ose është fituar me ndërrim me mallin e siguruar me shkelje administrative doganore. Nëse, ndalimi i mallit nuk është më i nevojshëm për procedurën e mëturshme, malli duhet t'i kthehet personit nga i cili është marrë. Dogana mund të ndalojë mallin në pajtim me paragrafin 2 dhe 5 të këtij neni, pa marre parasysh të drejtat e personave të tretë.

⁸ (Neni 12 parag 1-5) Kur një person kërkon që Dogana të merr një vendim në lidhje me aplikimin e legjislacionit doganor, ai person duhet të sigurojë të gjitha informatat dhe dokumentet që kërkohen nga Dogana, në mënyrë që të merrret një vendim. Një vendim i tillë do të merrret dhe do të njoftohet kërkuesi në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative. Vendimi i sjellë nga Dogana me shkrim, me të cilin refuzohet kërkesa ose është në dëm të personave të cilëve iu është adresuar, do të arsyetojnë bazën në të cilën mbështetet ai vendim dhe do t'iu njohin të drejtën për ankesë të parapare sipas nenin 291. Dogana mund të vendosë që dispozita e paragrafit 3 të zbatohet njësoj edhe për vendimet tjera. Dispozitat e Ligjit mbi procedurën administrative aplikohen në procedurat, të cilat i zhvillon Dogana, vetëm nëse nuk është parapare ndryshe me dispozitat e këtij Kodi.

Në procedurë për shkelje administrative doganore, nuk mund të iniciohet pas kalimit të afatit prej tre vitesh nga dita e kryerjes së shkeljes administrative. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit të autorizuar të ndërmarrë në drejtim të ndjekjes së kryesit të kundërvajtjes. Pas çdo ndërprerje afati i parashkrimit fillon serish të rrjedhë, mirëpo procedura për shkelje administrative doganore nuk mundet, në asnjë rast të iniciohet ose të zhvillohet më tutje, pas skadimit të afatit prej 5 vitesh, nga dita e kryerjes së shkeljes administrative.⁹

VI. Taksa e Akcizës për Produkte me Akcizë

Secilit produkt me akcizë i caktohet akciza në tarifën e cila vlen për të në datën dhe kohën kur produkti lëshohet në qarkullim në Kosovë. Kur caktohet akciza për produktin me akcizë, i cili lëshohet në qarkullim nëpërmjet largimit, prodhimit apo importimit të kundërligjshëm, akciza duhet të paguhet menjëherë për atë produkt me akcizë dhe derisa ajo të paguhet produkti i nënshtrohet ndalimit dhe konfiskimit. Në qoftë se në kohën e lëshimit në qarkullim të ndonjë produkti me akcizë tashmë është paguar një shumë e akcizës përkitazi me atë produkt për ndonjë pullë fiskale ose banderolë të ngjitur në të, akciza caktohet vetëm aq sa është dallimi në mes të tarifës e cila vlen në kohën e lëshimit, në qarkullim dhe shumës së paguar për pullën fiskale ose banderolën. Kur caktohet akciza për importimin e ndonjë produkti me akcizë në bazë të vlerës së produktit, duke përfshirë importimin e kundërligjshëm të tij, ajo caktohet në bazë të vlerës së produktit për qëllime të importimit, bashkë me ndonjë obligim doganor që duhet të paguhet për importimin e atij produkti, por duke e përjashtuar tatimin në vlerën e shtuar, që duhet të paguhet për importimin e këtij produkti. Tarifatat e tanishme të akcizës si dhe produktet që i nënshtrohen akcizës janë përcaktuar me Legjislacion në fuqi.

Akciza në import caktohet dhe paguhet sikur të ishte detyrë e doganave. Asnjë produkt i cili nuk dërgohet në një depo tjetër të autorizuar për mallra me akcizë, të ndonjë tregtar i autorizuar i mallrave me akcizë ose që nuk eksportohet, nuk mund të largohet nga depoja e autorizuar e mallrave me akcizë, përveç nëse është paguar akciza që duhet të paguhet për atë produkt nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë i asaj depoje. Nëse, Dogana vlerëson se akciza e cila duhet të paguhet është e garantuar, ai mund t'i lejojë ndonjë depoisti të autorizuar të mallrave me akcizë, që akcizën të cilën duhet ta paguajë, ta paguajë me këste javore ose mujore. Drejtori i përgjithshëm, pas konsultimit me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, me anë të Udhëzimit Administrativ, i përcakton formularët, të cilët duhet të përdoren nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë, për ta paguar akcizën dhe regjistrat tjerë të cilët duhet të mbahen, si dhe kushtet tjera të cilat mund të zbatohen ndaj depoistit të autorizuar të mallrave me akcizë, i cili e paguan akcizën. Nëse, akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas ligjit, kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, Dogana mund ta vlerësojë shumën e akcizës që duhet të paguhet dhe e njofton personin, i cili e ka dhënë garancionin, për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës, që duhet të paguhet menjëherë nga personi i cili e ka dhënë garancionin, prandaj kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve prej datës së njoftimit.

Nëse, akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas ligjit kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, Dogana mund ta vlerësojë shumën e akcizës që duhet të paguhet dhe e njofton depoistin e autorizuar të mallrave me akcizë, për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës, që duhet të paguhet menjëherë nga depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë dhe kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve, prej datës së njoftimit. Nëse, akciza konsiderohet se duhet të paguhet sipas dispozitave ligjore, kurse nuk paguhet brenda një muaji prej datës kur është zbuluar humbja, Dogana mund ta vlerësojë shumën e akcizës, që duhet të paguhet dhe e njofton

⁹ Neni 274-284 i KDA-së

tregtarin e autorizuar të mallrave me akcizë, për atë shumë dhe kjo shumë konsiderohet si një shumë e akcizës, që duhet të paguhet menjëherë nga tregtari i autorizuar i mallrave me akcizë dhe kërkohet të paguhet nga ai brenda 30 ditëve, prej datës së njoftimit. Kur bëhet vlerësimi në bazë të ligjit, kamata caktohet sipas tarifës së tregut deri në datën e vlerësimit prej datës së humbjes ose, nëse kjo nuk mund të vërtetohet, prej datës kur mallrat janë futur në marrëveshjen më të fundit për pezullim, të cilës i janë nënshtruar.

Njoftimi për vlerësim:

- konsiderohet se është bërë, nëse është dorëzuar ose është lënë në adresën e përcaktuar në garancion të personit, i cili e ka dhënë atë garancion.
- konsiderohet se është bërë, nëse është dorëzuar ose është lënë në depon e autorizuar të mallrave me akcizë, për të cilën është caktuar depoisti i autorizuar i mallrave me akcizë dhe konsiderohet se është bërë, nëse është dorëzuar ose është lënë në objektet rreth të cilave tregtari i autorizuar i mallrave me akcizë ka të drejtë, që të pranojë mallra me akcizë në bazë të marrëveshjes për pezullim.

V. Importi i Përkohshëm

Dogana siguron që periudha e përgjithshme gjatë së cilës malli gjendet nën procedurë IP për të njëjtin qëllim dhe nën përgjegjësinë e të njëjtit mbajtës, mos e tejkalojë 24 muaj madje edhe në rastet kur procedurat janë shkarkuar për procedurë tjetër, duke ndërprerë pagesat dhe deklarinin e përsëritur për import të përkohshëm.

Megjithatë, në kërkesë të mbajtësit, ato këtë periudhë mund ta vazhdojnë për kohën kur malli nuk shfrytëzohet, sipas kushteve të cilat ata i kanë paraparë. 3. Për qëllimet e neni 143 paragrafi 3 i Kodit të Doganave dhe Akcizës, masat përjashtimore nënkuptojnë ndonjë ngjarje e cila rezulton, që masat duhet të shfrytëzohen për kohën e mëtejme, në mënyrë që të plotësojnë qëllimin për operim të importit të përkohshëm.

Mallrat e vendosura në procedura duhet të mbesin në të njëjtën gjendje. Riparimet dhe mirëmbajtja, duke përfshirë riparimet kapitale dhe përshtatjet apo masat për të ruajtur mallrat apo për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për shfrytëzim të tyre sipas procedurave janë të lejueshme. Importimi i përkohshëm me lirim të plotë nga detyrimet e importit (më tutje referohet si: lirimi i plotë nga detyrimet e importit¹⁰) duhet të jepet vetëm në përputhje me nenet 331 deri 353. Importi i përkohshëm me lirim të pjesshëm nga taksat e importit, nuk duhet të jepet për mallrat e konsumueshëm.¹⁰

-Ankesat/Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit

Çdo person i cili ka pranuar një vendim nga dogana ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e tij, i cili ka të bëjë me aplikimin e legjislacionit doganor, vendim i cili ka të bëjë me të në mënyrë direkte ose indirekte. Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit i paraqitet Sektorit të Ankesave doganore brenda tridhjetë (30) ditëve që nga data e pranimin të vendimit të kundërshtuar. Sektori i Ankesave në rishqyrtim të vendimit doganor mund të:

- refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe konfirmon vendimin e kundërshtuar;

¹⁰ [UA 11/2009](#)

- aprovon kërkesën dhe anulon vendimin e kundërshtuar;
- aprovon kërkesën dhe revokon vendimin e kundërshtuar;
- aprovon kërkesën pjesërisht dhe ndryshon vendimin e kundërshtuar.

Sektori i Ankesave doganore vendos në kërkesë për rishqyrtimin, përmes aktit me shkrim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Vendimi i Sektorit të Ankesave mund të ankohet tek Bordi i Pavarur i Rishqyrtimeve, në pajtim me Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të vendimit nga Sektori i Ankesave, për të gjitha vendimet e pranuar deri më 30 nëntor 2012. Ndërsa nga 1 dhjetori 2012 organi kompetent i caktuar për të pranuar ankesën kundër vendimeve të Sektorit të Ankesave do të jetë Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Kur Bordi i Pavarur i Rishqyrtimit mbanë seancë të mbyllur, Dogana përgjigjet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve që nga dita e njoftimit të lidhur me ankesën. Kur bordi mbanë seancë të hapur, Dogana përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar.

Procedurat para gjykatës kompetente duhet të rregullohen nga rregullat procedurale të përcaktuara me Ligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligji për gjykatat, Ligji për Konfliktet Administrative dhe nga ndonjë ligj tjetër relevant në Kosovë. Kundër vendimit të gjykatës kompetente, pala e interesuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në pajtim me Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat përmbajtëse në këtë kod, dispozitat e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat duhet të gjejë aplikimin për gjithë procedurën e ankesave. Në rast se edhe me këtë ligj nuk është paraparë rregullimi i ndonjë dispozite të procedurës së ankesës, do të gjejë zbatim Ligji i procedurës së përgjithshme administrative si ligj subsidiar.¹¹

VI. PËRMBLEDHJE

Punimi ka arritur të japë një pasqyre të plotë të çështjeve më kryesore që gjykohen në gjykate. Në këtë modul është munduar të elaborohet dhe të gërshetohet ana teorikë me raste praktike në mënyre që të kuptohet me drejt materialisht që përfshinë çështjet doganore duke demonstruar me raste praktike të lartecikura, pyetje dhe raste hipotetike vete me qëllim që pjesëmarrësit të kenë kuptuar drejtë çështjen e tilla juridike të cilat rregullohen me legjislacionin në fuqi.

Nga materiali i lartecikur dhe rastet praktike pas përfundimit pjesëmarrësit do të kenë njohuri lidhur me rastet praktike për legjislacionin aplikueshëm në përgjithësi si dhe legjislacioni doganor në veçanti, si dhe qasje me aktive gjate trajnimit, bashkëbisedimit dhe punës praktike dhe individuale dhe grupe në mënyre që pjesëmarrësit të përfitojnë dije dhe shkathësi në pajtim me qëllimet dhe objektivat e këtij trajnimit. Trajtimin e këtyre çështjeve do të mundësojë pjesëmarrësve që të kenë një pasqyre me të qarte lidhur me këto çështje juridike, dhe pas këtij trajnimit pjesëmarrësit do të kenë njohuri me shume në Çështjeve Doganore dhe tatimore, dhe juridiksionin gjyqësor të këtyre çështjeve.

¹¹ Ligji nr. 04/L-099 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë. (Qershor 2012).